

Fjala e Paqes



"Dhe, ja,
unë jam me ju
gjithmonë
deri në të sosur
të botës"
(Mt 28,20)

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult **Nr. 3 (134) Viti XIX Prill - Maj 2017**

PAPA FRANÇESKUT NË EGJIPT



Ati i Shenjt Françesku bëri Udhëtimin Apostolik në Egjipt në dt. 28-29 prill 2017. Mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare për Paqen, tek Al-azhar Conference Centre, Kairo. Në vijim Fjala e Atit të Shenjtë drejtuar pjesëmarrësve, e premte, 28 prill 2017.

“Al Salamò Alaikum!

Është një dhuratë e madhe të jem këtu dhe të filloj në këtë vend vizitën time në Egjipt, duke ju drejtuar juve në kuadrin e kësaj Konferencë Ndërkombëtare për Paqen. Falënderoj vëllain tim, Imamin e Madh që e ka ideuar dhe organizuar atë dhe që më ka ftuar me mirësjellje. Dëshiroj t'ju paraqes disa mendime, duke i nxjerrë nga historia e lavdishme e kësaj toke, që në shekuj i është shfaqur botës si

tokë e qytetërimit dhe tokë e besëlidhjeve.

Tokë e qytetërimit. Qysh nga lashtësia, qytetërimi i lindur në brigjet e Nilit ka qenë sinonim i civilizimit: në Egjipt është ngritur lart drita e njohjes, duke bërë të lind një trashëgimi kulturore e paçmueshme, e bërë me urtësi dhe zgjuars, me njohuri matematike dhe astronomike, me forma të mrekullueshme arkitekture dhe me art figurativ. Kërkimi i dijes dhe vlera e arsimit kanë qenë zgjedhje të frytshme zhvillimi të ndërmarrë nga banorët e lashtë të kësaj toke. Janë edhe zgjedhje të nevojshme për të ardhmen, zgjedhje paqeje dhe për paqen, mbasi nuk do të ketë paqe pa një edukim të përshtatshëm të brezave të rinj. E nuk do të ketë një arsim të përshtatshëm për të rinjtë e sotëm nëse formimi që u jepet atyre nuk do t'i përgjigjet plotësisht natyrës së njeriut, genie e hapur

Vijon në fq. 2

IPESHKVINJTË E SHQIPËRISË NË VIZITË “AD LIMINA APOSTOLORUM”



PAPA FRANÇESKU NË EGJIPT

Vijim i fq. 1

dhe e arsyeshme.

Edukimi bëhet në të vërtetë urti jete kur është në gjendje të nxjerrë nga njeriu, në kontakt me Atë që është mbi të dhe me atë që e rrethon, më të mirën e vetes, duke formuar identitete jo të mbyllura në vetvete. Urtia kërkon tjetrin, duke kapërcyer tundimin për t'u ngurtësuar dhe për t'u mbyllur; e hapur dhe në lëvizje, e përvujtë dhe hulumtuese në të njëjtën kohë, ajo di ta vlerësojë të kaluarën dhe ta vërë në dialog me të tashmen, pa hequr dorë nga një hermeneutikë e përshtatshme. Kjo urti përgatit një të ardhme në të cilën nuk synohet mbizotërimi i anës së vet, por tjetri si pjesë përbërëse e vetes; ajo nuk lodhet, në të tashmen, të gjejë raste takimi dhe bashkëndarjeje; nga e kaluara mëson se prej së keqes buron vetëm e keqja dhe prej dhunës vetëm dhuna, në një rritje konstante që më në fund robëron. Kjo urti, duke refuzuar lakminë e veprimit të padrejtë, vë në qendër dinjitetin e njeriut, i çmueshëm para syve të Zotit, dhe një etikë që të jetë e denjë për njeriun, duke refuzuar frikën nga tjetri dhe druajtjen për të njohur me anë të këtyre mjeteve me të cilat e ka p a j i s u r Krijuesi.

Pikërisht në fushën e dialogut, si domosdërfetar, jemi gjithnjë të thirrur për të ecur së bashku, në bindjen se e ardhmja e të gjithëve varet edhe nga takimi mes feve dhe kulturave. Në këtë drejtim puna e Komitetit të përzier për Dialogun ndërmjet Këshillit Papnor për Dialogun Ndërfetar dhe Komitetit të Al-Azhar-it për Dialogun na jep një shembull konkret dhe inkurajues. Tri orientime themelore, nëse pajtohen mirë, mund të ndihmojnë dialogun: detyra e identitetit, guximi i asaj që është e ndryshme dhe sinqeriteti i qëllimeve. Detyra e idinetitetit, pasi nuk mund të ravijëzohet një dialog i vërtetë mbi dyfaqësinë ose mbi sakrifikimin e të mirës për t'i pëlqyer tjetrit; guximi i asaj që është e ndryshme, mbasi ai që është i ndryshëm nga unë, nga ana kulturore ose nga ana fetare, nuk duhet parë as trajtuar si një armik, por të pranohet si një shok udhëtimi, në bindjen e sinqertë se e mira e secilit qëndron tek e mira e të gjithëve; sinqeriteti i qëllimeve, sepse dialogu, si shprehje autentike e njerëzores, nuk është një strategji për të realizuar qëllime të dyta, por një rrugë e vërtetë, që meriton të ndërmerret me durim për ta shndërruar garën në bashkëpunim.

Edukimi ndaj hapjes së respektshme dhe të dialogut të sinqertë me tjetrin, duke ia njohur të drejtat dhe liritë themelore, sidomos atë fetare, është rruga më e mirë për të ndërtuar së bashku të ardhmen, për të qenë ndërtues të qytetërimit. Pasi e vetmja alternativë ndaj qytetërimit të takimit është mosqytetërimi i përplasjes, nuk ekziston një tjetër. E për të kundërshtuar me të vërtetë barbarizmin e atij që fryn mbi urrejtjen dhe nxit dhunën, lypset të shoqërojmë dhe të pjekim breza që i përgjigjen logjikës zjarrëvënëse të së keqes me rritjen e durueshme të së mirës: të rinj që, si pemë të ngulura mirë, të jenë të rrënjosur në truallin e historisë e, duke u rritur Lart dhe pranë të tjerëve, ta shndërrojnë çdo ditë ajrin e ndotur të urrejtjes në oksigjenin e vëllazërisë.

Në këtë sfidë qytetërimi kaq urgjente dhe të pasionuar jemi të thirrur, të krishterë e myslimanë, dhe të gjithë besimtarët, për të dhënë kontributin tonë: “jetojmë nën diellin e një Zoti të vetëm të mëshirshëm. [...] Në këtë kuptim mundemi pra ta thërrasim njëri-

tjetrin vëllezër e motra [...], mbasi pa Zotin jeta e njeriut do të ishte si qielli pa diellin”. Le të lind dielli i një vëllazërie të përtërirë në emër të Zotit dhe le të dalë nga kjo tokë, e puthur nga dielli, agimi i një qytetërimi të paqes dhe të takimit. Ndërmjetëssoftë për këtë Shën Françesku i Asizit, që tetë shekuj më parë erdhi në Egjipt dhe takoi Sulltanin Malik al Kamil.

Tokë e besëlidhjeve. Në Egjipt nuk ka lindur vetëm dielli i urtisë; edhe drita shumëngjyrëshe e feve e ka ndriçuar këtë tokë: këtu, gjatë shekujve, “dallimet e feve kanë qenë “një formë pasurimi reciprok në shërbim të bashkësisë së vetme kombëtare”. Fe të ndryshme janë takuar dhe kultura të ndryshme janë përzier, pa u ngatërruar por duke njohur rëndësinë për të bërë besëlidhje për të mirën e përbashkët. Besëlidhje të këtij lloji janë sot më urgjente se kurrë. Duke folur për këtë, dëshiroj të përdorë si simbol “Malin e Besëlidhjes” që ngrihet në këtë tokë. Sinai na kujton para së gjithash se një besëlidhje e vërtetë në tokë nuk mund të arrihet duke përjashtuar Qiellin, se njerëzimi nuk

m u n d t ë vendos të takohet në paqe duke përjashtuar Zotin nga horizonti, e as nuk mund të ngjitet në mal për ta zotëruar Zotin (khs. Dal 19,12).

Ë s h t ë fjala për një m e s a z h a k t u a l , p ë r b a l l ë vazhdimin të një paradoksi t ë rrezikshëm, për të cilin nga njëra anë e k z i s t o n prirja për ta syrgjynosur

fenë në sferën private, pa e njohur si përmasë përbërëse të qenies njerëzore dhe të shoqërisë; nga tjetra ngatërrohet, pa dalluar si duhet, sfera fetare dhe ajo politike. Ekziston rreziku që feja të përthithet nga drejtimi i çështjeve tokësore dhe të tundohet nga joshjet e pushteteve të kësaj bote që në të vërtetë e instrumentalizojnë atë. Në një botë që ka globalizuar shumë mjete teknike të dobishme, por në të njëjtën kohë shumë indiferencë dhe moskokëçarje, dhe që rend me një shpejtësi frenetike, që qëndron me vështirësi, ndihet nostalgjia e pyetjeve të mëdha të kuptimit, që fetë bëjnë të dalin në dritë dhe që ngjallin kujtimin e zanafillave të veta: prirja e njeriut, që nuk është krijuar për t'u shteruar në pasigurinë e punëve tokësore, por për të ecur drejt Absolutit kah i cili priret. Për këto arsye, sidomos sot, feja nuk është një problem por është pjesë e zgjidhjes: kundër tundimit për t'u përshtatur në një jetë të rrafshtë, ku gjithçka lind dhe përfundon në këtë botë, ajo na kujton se është e nevojshme ta ngrejmë shpirtin Lart për të mësuar të ndërtojmë qytetin e njerëzve.

Në këtë kuptim, duke e kthyer përsëri idealisht shikimin nga Mali Sinai, dëshiroj t'u referohem atyre urdhërimeve, të shpallura atje, para se të shkruheshin në gur. Në qendër të “dhjetë fjalëve” kumbon, drejtuar njerëzve dhe popujve të të gjitha kohëve, urdhërimi “mos vra” (Dal 20,13). Hyji, dashurues i jetës, nuk pushon së dashuri njeriun dhe për këtë e nxit ta kundërshtojë rrugën e dhunës, si parakusht themelor i çdo besëlidhjeje në tokë. Për ta zbatuar këtë imperativ janë të thirrur, para së gjithash dhe sot në veçanti, fetë pasi, ndërsa gjendemi në nevojën e ngutshme për Absolutin, është e domosdoshme të përjashtojmë çdo absolutizim që justifikon forma dhune. Dhuna, në të vërtetë, është mohimi i çdo fetarie të mirëfilltë.

Si përgjegjës fetarë, jemi pra të thirrur të demaskojmë dhunën që maskohet me shenjtëri të pandehur, duke u mbështetur mbi

Vijon në fq. 3



PAPA FRANÇESKU NË EGJIPT

Vijim i fq. 1

absolutizimin e egoizmave në vend të hapjes autentike ndaj Absolutit. E kemi për detyrë të denoncojmë dhunimet kundër dinjitetit njerëzor dhe kundër të drejtave njerëzore, të nxjerrim në dritë përpjekjet për të justifikuar çdo formë urrejtjeje në emër të fesë dhe t'i dënojmë ato si falsifikim idhujtar i Zotit: emri i tij është i Shenjtë, Ai është Zoti i paqes, Zoti salam. Prandaj vetëm paqja është e shenjtë dhe asnjë dhunë nuk mund të kryhet në emër të Zotit, sepse do ta përdhoste Emrin e tij.

Së bashku, nga ky vend takimi mes Qiellit dhe tokës, besëlidhësh mes popujsh dhe besimtarësh, le t'ia përsërisim një “jo” të fortë çdo forme të dhunës, hakmarrjes dhe urrejtjes të kryera në emër të fesë ose në emër të Zotit. Së bashku le ta pohojmë papajtueshmërinë mes dhunës dhe fesë, mes të besuarit dhe të urreyerit. Së bashku le ta shpallim karakterin e shenjtë të çdo jete njerëzore kundër çdo dhune fizike, shoqërore, edukative apo psikologjike. Feja që nuk lind nga një zemër e sinqertë dhe nga një dashuri e vërtetë ndaj Zotit të Mëshirshëm është një formë bashkimi konvencional ose social që nuk e liron njeriun por e shtyp atë. Të themi së bashku: sa më shumë rritemi në besim te Zoti aq më shumë rritemi në dashuri ndaj të afërmit.

Por feja sigurisht nuk është vetëm e thirrur për të demaskuar të keqen; ka në vetvete prirjen për të nxitur paqen, sot me gjasë si kurrë më parë. Pa rënë në sinkretizma pajtues, detyra jonë është ajo të lutemi për njëri-tjetrin duke i kërkuar Hyjit dhuratën e paqes, të takohemi, të dialogojmë, dhe të nxisim harmoninë në frymën e bashkëpunimit dhe të miqësisë. Ne, si të krishterë – e unë jam i krishterë – “nuk mund ta lusim Hyjin si Atë të të gjithë njerëzve, nëse nuk pranojmë të sillemi si vëllezër ndaj disave ndër njerëzit që janë të krijuar në shëmbëlltyrë të Hyjit”. Vëllezër të të gjithëve. Për më tepër, të pranojmë që, të zhytur në një luftë të vazhdueshme kundër së keqes e cila e kërcënon botën që të mos jetë më “fusha e një miqësie të vërtetë”, ata “që besojnë në dashurinë hyjnore, janë siguruar prej Tij [Zotit] se rruga e dashurisë është e hapur për të gjithë njerëzit dhe se përpjekjet e mëdha për të realizuar miqësinë

mes të gjithë njerëzve nuk janë të kota”. Madje, janë thelbësore: pak ose asgjë nuk vlen në të vërtetë ta ngrejmë zërin dhe të vrapojmë për t'u riarmatosur për t'u mbrojtur: sot kemi nevojë për ndërtues paqeje, jo armësh; sot kemi nevojë për ndërtues paqeje, jo për nxitës konfliktesh; për zjarrfikës jo për zjarrvënës, predikues pajtimi dhe jo për tellallë shkatërrimi.

Jemi të pranishëm me shqetësim në faktin se, ndërsa nga njëra anë largohemi nga realiteti i popujve, në emër të qëllimeve që nuk shikojnë në fytyrë askënd, nga tjetra, për reagim, lindin populizma demagogjikë, që sigurisht nuk ndihmojnë për të konsoliduar paqen dhe stabilitetin: asnjë nxitje e dhunshme nuk do ta garantojë paqen, dhe çdo veprim i njëanshëm që nuk nis procese ndërtuese dhe pjesëmarrëse është në realitet një dhuratë ndaj nxitësve të radikalizmave dhe të dhunës.

Për të parandaluar konfliktet dhe për të ndërtuar paqen është themelore të përpiqemi të heqim gjendjet e varfërisë dhe të shfrytëzimit, ku ekstremizmat lëshojnë rrënjë më lehtë, dhe të bllokojmë flukset e parave dhe të armëve drejt atyre që nxisin dhunën. Edhe më në rrënjë, është e nevojshme të ndalet përhapja e armëve që, nëse prodhohen dhe tregëtohen, heret a vonë edhe do të përdoren. Vetëm duke i bërë transparente manovrat e turbullta që ushqejnë kancerin e luftës mund të parandalohen shkaqet e saj të vërteta. Kjo detyrë e ngutshme dhe e rëndë u bie përgjegjësve të kombeve, të institucioneve dhe të informimit, ashtu si edhe ne përgjegjësve të qytetërimit, të thirrur nga Hyji, nga historia dhe nga e ardhmja për të nisur, secili në fushën e vet, procese paqeje, duke mos u shmangur nga hedhja e themeleve të forta të aleancave mes popujve dhe Shteteve. Uroj që kjo tokë fisnike dhe e dashur e Egjiptit, me ndihmën e Zotit, të mund t'i përgjigjet përsëri, thirrjes së saj për qytetërim dhe për besëlidhje, duke ndihmuar për zhvillimin e procesve të paqes për këtë popull të dashur dhe për krejt rajonin e lindjes së mesme. Al Salamò Alaikum!”

Nga www.vatican.va

IPESHKVINJTË E SHQIPËRISË NË VIZITË “AD LIMINA APOSTOLORUM”

Nga 25 maj deri më 1 qershor 2017 Ipeshkvinjtë e Kishës Katolike në Shqipëri kanë kryer Vizitën ad Limina tek Selia e Shenjtë.

Me 27 maj Ipeshkvinjtë kanë qenë ftuar nga Ambasada Shqiptare në Vatikan për një koncert në rastin e 550 Vjetorit të Zojës së Këshillit të Mirë tek “Salla Accademia Pontificio Istituto di Musica Sacra”, in Piazza Sant'Agostino, në orën 18.30, me nismën e të Ngarkuarit me Punë, Z. Visar Zhiti me bashkshorten.

Kanë takuar Kongregatat më të rëndësishme, sipas programit, dhe Papa Françeskun. Kanë kremtuar Meshën në katër Bazilikat e Medha dhe me 28, e diela e fundit e majit, kanë kremtuar Meshën në Gjenacano, ku mblidhen Shqiptarët katolikë të Italisë. Duke qenë 550 vjetorin i Arritjes së Figurës në Gjenacano, ishte i pranishëm edhe Kardinali ynë, Dom Ernest Troshani, i cili kryesoi Meshën Pontifikale. Në vijim një sintesë e bisedës me Papën:

Papa tha Ipeshkvinjve shqiptarë: Angazhohuni më shumë për thirrjet, inkurajoni të rinjtë dhe shmangni “mondانيتin”. Me 30 maj Ipeshkvinjtë e takuan Shenjtërinë e Tij, Papa Françesku, në Vatikan. Ipeshkvinjtë janë në Romë për vizitën e tyre ad limina. Kjo është një vizitë që çdo Ipeshkëv duhet t'a bëjë njëherë në pesë vjet në Romë për t'u takuar me Papën dhe me dikasteret romake. Gjatë vizitës, në një klimë të ngrohtë dhe vëllazërore, Papa Françesku dëgjoi me vëmendje çdo gjë që Ipeshkvinjtë i treguan rreth jetës së Kishës në Shqipëri dhe angazhimit të tyre për ungjillëzimin.

Papa, pasi shfaqti solidaritetin e tij me Kishën në Shqipëri, falenderoi Ipeshkvinjtë për misionin e tyre për të ringjallur Kishën pas diktaturës ateiste dhe mizore komuniste. Ai kujtoi me mallëngjim vizitën e tij në shtator 2014, sidomos ngaqë për t'a pritur kishin dalë mijëra të rinj.

Ipeshkvinjtë i treguan se komuniteti katolik është rritur gjatë këtyre njezet e pesë viteve.

Papa Françesku theksoi tre gjëra në fjalën e tij: Së pari, duhet të angazhohemi më shumë për thirrjet e jetës meshtarake dhe asaj të kushtuar, duke i inkurajuar të rinjtë të mos kenë frikë t'i thonë “po” Zotit. Së dyti, duhet të formojmë të rinjtë që të bëhen tharmi i shoqërisë sepse nga ta varet e ardhmja e Kishës dhe e gjithë shoqërisë. Së treti, është e domosdoshme të shmangim “mondانيتit”, e thënë ndryshe, frymën e materializmit dhe konsumizmit.

Në fund të takimit, Ipeshkvinjtë i dhuruan Atit të Shenjtë dy vëllimet me jetën e martirëve dhe figurën e të Lumë Martirëve tanë.

Programi i Vizitës Ad Limina Apostolorum

E enjte, 25 maj: Arritja në Romë

E premte, 26 maj:

7.30. Mesha pranë Bazilikës së Shën Pjetrit

9.30. Kongregata për Ipeshkvijtë (Sheshi Piu XII, 10)

11.30. Dikasteri për zhvillimin Njerëzor të Tërësishëm të

Njeriut (Pallati Shën Kalisti)

E shtunë, 27 maj:

8.00. Mesha pranë Bazilikës Santa Maria Maggiore

11.00. Kongregata për Klerin (Sheshi Piu XII, 3)

E hënë, 29 maj:

10.00. Kongregata për Doktrinën e Fesë (Sheshi Sant'Ufficio)

12.30. Kongregata për Institutet e Jetës së Kushtuar Zotit (Sheshi Piu XII, 3)

16.30 Mesha në Bazilikën e Shën Gjonit në Lateran

18.00. Sekretaria e Shtetit, Seksioni i Dytë

E martë, 30 maj:

10.30-12.30. Audienca me Atin e Shenjtë

15.30. Dikasteri për Familjen, Jetën e Laikët (Sheshi Shën Kalisti, 16)

17.00. Këshilli Papnor për Dialogun Ndërfetar (Via Conciliazione, 5)

E mërkure, 31 maj

9.30 . Kongregata për Kultin Hyjnor (Sheshi Piu XII, 10)

11.30. Këshilli Papnor për Nxitjen e Bashkimit të të Krishterëve (Via Conciliazione, 5)

17.00. Mesha pranë Bazilikës së Shën Palit Jashtë Mureve

E enjte, 1 qershor

9.30 Kongregata për Edukimin Katolik (Sheshi Piu XII, 3)

11.00 Këshilli Papnor Tekstet Legjislative (Sheshi Piu XII).

Të thirrur për t'u shërbyer të sëmurëve

Kjo ishte tema e cila iu dedikua edukatorëve të cilët punojnë nëpër institucionet e Kishës katolike në shërbim të të sëmurëve dhe njerëzve me aftësi ndryshe, të shtëpi-familjes së Motrave të Nenë Terezës, Projekti Shpresa, Madonnina del Grappa si dhe Vëllezërve të Nenë Terezës nga Bushati. Aktiviteti u organizua nga Caritasi dioqezan si dhe me nxitjen e Arqipeshkvit Mons. Angelo Massafra i cili jo vetëm i mbështetë veprimtaritë, por edhe i shoqëron ato me praninë e Tij. Këtë radhë u zhvillua në Shkoder me dt. 03.04.2017 pranë Shoqatës Madonina del Grappa. Ishte një pasdite shpirtërore gjatë të cilës pjesëmarrësit morën pjesë në takimin të cilin e zhvilloj Dom Charbel Bachour (Drejtori i Caritasi, pastaj vijoj me liturgjinë pendestare duke qenë se ishim në kohën e krezhmeve siç theksoi Ipeshkvi duke vlersuar aktivitetin, njëkohësisht falenderoi edukatorët për punën e vështirë dhe të palodhshme që bëjnë me të semurët, por edhe duhet, tha Ai, “që të kujdesimi edhe per jetën tonë shpirtërore që të kemi me shumë guzim dhe të jemi sa me besnik me ndihmën e Zotit në punën e vështirë me të cilën përballeni çdo ditë”.

Gjithashtu, Dom Charbel gjatë reflektimit citoj disa pika që i krishtëri duhet të ketë



parasysh ndaj dhuratave që Zoti i jep secilit prej nesh, ne duhet të jemi të nxitur nga mesimet e Papa Franceskut i cili na meson që të kujdesemi për të sëmurët si praktikë e mëshirës që së pari e kemi marrë nga Zoti. Kjo do të thotë që kujdesi ynë ndaj të sëmurëve vjen nga besimi që kemi. Kështu kur takojmë njeriun me nevoja të veçanta shpirtërore, fizike, apo sociale, duhet ta ofrojnë Zotit këtë person dhe t'i ndihmojë të tjerët përmes dhimbjes së tyre..

Vërtet, shumë shpesh janë vetë të sëmurët që na ndihmojnë ta mbartim kryqin. Shpesh janë të sëmurët që na bekojnë me guximin e tyre dhe shpresë të qëndrueshme. Le të përqijemi pra, sa më shumë që ta jetojmë këtë Kreshme në

bashkim me të sëmurët. Le t'i ofrojmë ata në lutjet tona, agjërimin dhe pendesën jo vetëm për pjesëmarrjen tonë më të thellë në vdekjen dhe ngjalljen e Krishtit, por edhe për të afërmit tanë që vuajnë. Duke perfunduar këtë mbasditë shpirtërore por edhe miqesore, me porosinë ndaj kohës së shënjtë të Kreshmëve, qe të reflektojmë mbi thirrjen që t'iu shërbejmë të sëmurëve. Atëherë Misteri i dhuratës së jetës në secilin prej nesh bëhet më i çmuar në kohë të tilla. Le t'i ruajmë dhe t'i shërbejmë këtij misterit; sepse është misterit i vetë Zotit.

Donika Nikolli

PËRKUJTOHET REVOLTA ANTIKOMUNISTE NË SPAÇ

Me 21 Maj 2017, ditën e dielë, u organizua në Spaç të Mirditës ceremonia përkujtimore e Revoltës Antikomuniste të vitit 1973 e cila shpërtheu mes të dënuarve në Burgun e Spaçit. Është i pesti vit radhazi që kjo veprimtari organizohet nga Komisioni Drejtësi dhe Paqe i Shqipërisë, ent i Kishës katolike.

E zhvilluar gjatë paradites në mjediset ku dikur ndodhej burgu



famëkeq i Spaçit, në ceremoni morën pjesë rreth 200 persona. Pati përfaqësues nga shumë organizata të ish të përndjekurve politikë, përfaqësues të autoriteteve vendore, personalitete të shquara të politikës, artit, kulturës dhe medias. Në qendër të vëmendjes ishte heroizmi dhe sakrifica e të dënuarve të burgut të Spaçit, të cilët në kushtet e një represioni të egër, gjetën forcë në vete të ndërmerrnin një akt qëndrese.

Ajo që nisi si një shpërthim i zemërimit të dy të dënuarve ndaj keqtrajtimit nga rojat dhe punës sfilitëse në minierën e bakrit, u përhap si flaka në bar të thatë dhe përfshiu gjithë të burgosurit. Të organizuar, ata qenë në gjendje të mposhtnin rojat dhe për tre ditë u bënë zotër të vetëm të kampit.

Nga terrace e njëres prej fjetoreve, ata lëshonin thirrje kundër regjimit dhe shprehnin dëshirat për një shqipëri ku të mbretëronte pluralizmi politik dhe demokracia sipas modelit të vendeve të Europës perëndimore. Momenti kulmor i revoltës ishte ngritja e flamurit kombëtar, pa yll, mbi terracë. Flamuri u improvizua me një cohë të kuqe, mbi të cilën piktori Mersin Vlashi vizatoi shkabën e zezë dykrenare. Për tre ditët e kohëzgjatjes së revoltës, pranë falumrit bënë roje Ndrecë Çoku

dhe Shuajp Saiti. Autoritetet e shtypën me egërsi dhe revoltën duke përdorur repartee të trupave special të forcave të armatosura. Katër protagonistët u dënuan me vdekje dhe u ekzekutuan. Këta martirë ishin: Hajro Pashai, Dervish Bejko, Skënder Daja dhe Pal Zefi. Me 21 Maj 2017, në përvjetorin e 44 të revoltës, në një analogji shumë të goditur, përsëri moment kulmor i ceremonisë ishte ngritja e flamurit nën tingujt e flamurit kombëtar. Në mënyrë simbolike, flamuri u ngrit nga një pjesëmarrës i mbijetuar i revoltës, ndërkohë që katër nxënës të shkollës së mesme “Atë Pjetër Mëshkalla” mbanin një kraharor nga një fashë me emrat e martirëve të revoltës.

Presidenti i Komisionit Drejtësi dhe Paqe, njëkohësisht edhe Kryetar i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, Shkëlqesia e Tij Imzot Angelo Massafra ofim, u shpreh në fjalën e tij përshëndetëse: “Kur u njoha së pari me historinë e persekutimit komunist të popullit tim, habitesha si kishte mundësi që këta njerëz nuk kishin bërë rezistencë në mbrojtje të vlerave dhe besimit të tyre, si martirët tanë. Revolta e vitit 1973, vërteton qartas të kundërtën.”

“Është e domosdoshme pra,” vazhdom Imzot Massafra, “që burgu i Spaçit të merret në mbrojtje nga shteti dhe të shndërrohet në muzeum për t'u përcjellë historinë brezave të rinj në mënyrë që gabimet e saj të mos përsëriten. Po ashtu, që viktimat të kujtohen me nderimin dhe respektin që u takon, është e nevojshme që 21 Maji të shpallet si Dita Kombëtare e Kujtesës për viktimat e persekutimit Komunist në Shqipëri.” Duhet thënë se përmasat e ceremonisë përkujtimore kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit që prej herës së parë në vitin 2012.

Vladimir Banushi



Një përvojë e bukur Kishtare Evropiane



Në dt. 28-31 mars 2017 u mbajti në Barcelona (Spanjë) Simpoziumi nga CCEE (Konferenca e Konferencave e Kishave Evropiane) mbi "Shoqërimi i të rinjve" që t'i përgjigjen lirisht thirrjes së Krishtit me motojën: "PO ECTE ME TA" (Lk 24,15).

Simpoziumi mbi shoqërimin e të rinjve, organizuar nga Konferenca Ipeshkvore e Evropës filloi punimet e saj me 28 mars në Barcelonë me 275 pjesëmarrës të ardhur nga e gjithë Evropa. E veçanta e këtij Simpoziumi ka qënë pjesëmarrja e përgjegjësve të pesë sektorëve që punojnë me të rinjtë: Baritore Rinore, e Thirrjeve, Universiteteve, Shkollave dhe e Katekezës.

Ekspertë të fushave të ndryshme kanë referuar me shumë kompetencë duke ofruar pista të veçanta reflektimi, por edhe më interesante ka qënë shkëmbimi i përvojave të ndryshme baritore evropiane. Kemi pasur fatin të dëgjojmë edhe dëshmitë e katër të rinjve të katër shteteve të ndryshme, një prej tyre edhe Jona nga Shqipëria me dëshminë e saj të kthimit nga myslimane në besimin katolik.

Kremtimet liturgjike kanë shoqëruar gjatë gjithë kohës Simpoziumin, kemi pasur fatin të kremtojmë Meshën e Shenjtë në Bazilikën 'Sagrada Familia', e udhëhequr nga Kard. Bagnasco, president i CCEE. Para kremtimit, dy ekspert të veprës së Gaudí, skulptori Etsuro Sotoo dhe teologu Armando Puig, na kanë folur për bukurinë e finalizuar në ungjillzimin e të rinjve.

Arqipeshkvi i Barcelonës, Mons. Juan José Omella, ka ftuar të pranishmit për të ndjekun modelin e dishepujve të Emausit në shoqërimin e të rinjve, duke i dëgjuar ata e duke iu propozuar ndjekjen e Krishtit më nga afër.

Një tjetër përvojë e bukur ka qënë edhe shkëmbimi i informacioneve nëpërmjet "Praktikave të mira", ku secila fushë e punës baritore nga



kanë komunikuar disa sfida.

Përmbyllja e Simpoziumit i është besuar Kard. Angelo Bagnasco, President i CCEE, i cili është ndalur të flasë mbi figurën e edukatorit dhe rreth misionit të tij edukues në kontekstin aktual i karakterizuar nga "kultura e asgjësë". Ka vendosur theksin, edhe "nëse kultura bashkohore duket se nuk ka asgjë për t'u thënë të rinjve, asgjë domethënëse që ngroh



zemrën dhe mbush me jetë", në personin e Jezusit "shkëlqejnë të gjitha virtytet njerëzore, shkëlqen plotësisht humaniteti i njeriut, ai humanitet që në epokën tonë rrezikon të mos njihet dhe të reduktohet personi në një formë të lëngshme". Ka mbyllur takimin me një thirrje drejtuar të rinjve të Europës: "Brezin e ri e shohim me simpati e besim të madh, atyre u takon të jenë ungjillëzuesit e rinj, të bindur se të ungjillizosh sot do të thotë t'u mësosh njerëzve artin e të jetuarit! Koha jonë është një kohë e thatë, është koha që Provania Hyjnore na ka dhënë, ta përqafojmë me besim e dashuri (...). Po, duam të jetojmë mirë duke filluar të ndryshojmë vetveten dhe duke ndihmuar njëri-tjetrin."

Sympoziumi që kemi përjetuar me shumë entuziazëm ka qënë për ne një informim i mirë por edhe një nxitje për të shoqëruar të rinjtë në njohje më të thellë të Zotit dhe të jetojnë jetën në mision për të jetuar e kumtuar Ungjillin.

Mt. Rita Ndoci

vendet e ndryshme është bërë e pranishme me praktikatat që kanë. Kemi pasur mundësi të marrim informacione e të shkëmbejmë përvoja që Konferencat Ipeshkvore të ndryshme jetojnë në fushën e punës baritore me të rinjtë.

Kardinali Lorenzo Baldisseri, Sekretar i Përgjithshëm i Sinodit të Ipeshkvinjve, ka paraqitur punën parapërgaditore të Sinodit të të rinjve dhe thirrja që do të zhvillohet në tetor të vitit që vjen. Në fjalimin e tij na ka paraqitur punën për Dokumentin edhe një pyetësor që përfshinte të gjithë komponentët e Kishës. Në bazë të përgjigjeve që do t'i arrijnë komisionit, Sinodi i Ipeshkvinjve do të përpunojë një *Instrumentum Laboris* (Dokument pune) që u jepet Etërve Sinodalë si bazë për diskutimin e tyre. Në pritje të dokumentit të punës, Kard. Baldisseri tha që së shpejti do të jetë publike siti (www.sinodogiovani2018.va), ku është i pranishëm pyetsori i drejtuar direkt të rinjve. Përfaqësuesit e pesë fushave baritore, kanë bashkëndarë përvojën e tyre në Simpozium dhe



NË 550 VJETORIN MBËRRITJES SË IKONËS SË ZOJËS NË GJENACANO



DEKRETI EMERIMIT

“Te nderuarit Vëllalt tonë Kardinal Franc Rodé C.M.,
Prefekt emerito i Kongregates për Jetën e shuguruar dhe për Shoqatat e
Jetës apostolike,

Në 550 vjetorin e Mbërritjes së Ikonës të Zojës së Shkodrës në
Tempullin e Shenjtë të Gjenacanos, afër Romës, kushtuar Nënës së
Këshillit të Mirë, besimtarët të Shqipërisë të dashur, vazhdojnë për të
patur një devocion të veçantë ndaj të Lumes Zojës Mari dhe për
ndërhyrjen e Shpëtimtarit falënderojnë për të gjitha huret që kanë marrë
gjatë shekujve. Në Arqidioqezën Shkodër-Pult, në përgatitjen për të
kremtem e 26 prillit, kanë programuar disa nisma. Në fakt Nëna e Zotit,
Ikona e së cilës kujtohet fort, edhe në kohët e vështira ka vazhduar të
ndërmjetësoi për besimtarët
shqiptarë te Biri e Vet dhe
Zoti ynë, i cili ka dhenë huret e
veta. Për këtë Shën Gjon Pali
II foli qartë në Vizitën e Tij
Apostolike me 25 prill 1993
në Katedralen e Shkodrës, ku
bekoi Gurin e Parë e
Shenjtërores që do të
ndërtohej dhe besoi krejt
Popullin Shqiptar Nënës së
Këshillit të Mire.

Këtyre gjërave shtohet fakti
se i nderuari Vëlla Angelo
M a s s a f r a , O F M ,
Arqipeshkëv Metropolit i
Shkodër-Pult e President i
Konferencës Ipeshkvore të
Shqipërisë, kishte kërkuar me
përvujtëri një të Deleguar, për
të treguar edhe një herë
dashurinë tonë ndaj këtij populli. I nderuar Vëllai Ynë, ty, biri i famshëm
i Sllovenisë, që, dikur ke bërë mirë detyrën si Prefekti i Kongregates për
Jetën e Shuguruar dhe per Shoqatat e Jetes Apostolike, Ty të kam
menduar dhe me këtë letër të emërojmë I “Deleguari ynë i
Jashtëzakonshëm” për kremtimin që do të mbahet në Shenjtëroren
Kombëtare në Shkodër me 26 prill.

Do të kryesosh Kremtimin Eukaristik dhe do të përshendesësh
Arqipeshkvin Metropolit, Ipeshkvinj të tjerë, meshtarë, Rregulltarë dhe
Rregulltare, Autoritete Publike dhe të gjithë besimtarët. Dhe duke folur
për kultin ndaj Zojës Mari që ekziston në Shqipëri, të gjithë të pranishëm
duke dëgjuar homelin tënde mund të duam më shumë Jezusin nëpërmjet
Marisë.

I nderuar Vëllai Ynë, Ne do të percjellim në mision tuaj duke kërkuar
ndërmjetësinë e Zojës së Shkodrës dhe të të Lumëve Martirë: Imzot
Vinçenc Prennushi e 37 Shokët e Tij. Në fund Të japim Bekimin Tonë
Apostolik, shenjë e Mirësisë sonë ndaj Teje dhe peng e Hireve Hyjnore,
që mund t’u japësh të gjithë pjesëmarrësve në kremtim.



Nga Vatikani, 22 prill 2017

Viti i pest i Pontifikatit tonë.

FRANCISCUS

550-vjetori i Shpërnguljes së Ikonës së të Lumes Virgjër Mari

550-vjetori i Shpërnguljes së Ikonës së të Lumes Virgjër Mari,
Pajtores e Shkodrës, prej Shqipërisë në Gjenacan, ku mbërriti më 25 prill
1467, pak para rënies së Shkodrës së rrethuar prej ushtrisë otomane, ka
qenë një rast i volitshëm për një seri nismash fetare dhe kulturore. Me to
është dëshiruar të përtërihet në popullin shqiptar devocioni ndaj Pajtores
së tij, por është dëshiruar edhe që të sensibilizohet për një rizbulim dhe
një rilexim të atyre ngjarjeve të kobshme që, nga njëra anë, përcaktuan

mënjanimin e krishterimit
dhe, nga ana tjetër,
favorizuan rritjen e të
ashtuquajturës “shqiptari”,
ndjenjën e përkatësisë një
toke dhe një kulture që, ende
e d h e s o t , p ë r b ë n
k u n d ë r h e l m i n p ë r
intolerancën fetare që, në
Shqipëri më shumë se kudo
tjetër, paraqitet në format e
bashkëjetesës paqësore.
Pikërisht në këtë ndjenjë
përkatësie duhet bërë thirrje
për të kapërcyer vështirësitë
që gjithsesi nuk mungojnë.

Përtej përqindjeve, ato
që kanë rëndësi janë format
shprehëse të fesë së thjeshtë
të popullit! Shqiptari nuk ia
vë veshin përkatësisë së vet

fetare nëse bëhet fjalë për të shkuar në shtegtim në Shenjtëroren e “Zojës
së Shkodrës” apo atë të Shën Ndout në Laç të Kurbinit: një devocion që e
jetojnë duke iu nënshtruar çdo situatë meteorologjike dhe që shpreh fenë
e tyre të fortë. Shumë vetë, përvujtërisht, vijnë të të pyesin nëse
shtegtimi i tyre kërkon ndonjë formalitet më tepër, por kjo fe e thjeshtë i
befason edhe ata që janë më të vlerësuarit në rrethin tonë kishtar.

Dhe pikërisht këtë fe, të shprehur në këtë mënyrë, ka mundur ta
vërejë dhe ta lëvdojë Hirësia e tij Kardinali Rodé, i dërguar nga Ati i
Shenjtë Françesku për këtë rast. Ai, duke marrë pjesë në të gjitha nismat
e organizuara me këtë rast, së bashku me sekretarin e vet që dëshmitar i
asaj se sa parësore është për këtë popull shqiptar që ta njohë veten në
fytirën e Pajtores së vet. Është çështje identiteti që nuk mund të vihet në
diskutim në asnjë mënyrë.

Kështu, që në mëngjesin pas udhëtimit të tij natën e 24 prillit 2017
ku në Tiranë ishte pritur nga Imzot Romanus Mbena, i Ngarkuari me
Punët e Nunciaturës, nga Arqipeshkvi dhe nga Delegacioni zyrtar i
përbërë nga Dom Nikolin Toma, Vikar i përgjithshëm i Arkidioqezës së
Shkodrës, e nga Dom Simon Kulli, Administrator Dioqezan i Sapës, ai
Vijon në fq. 7

NË 550 VJETORIN I ARRITJES SË IKONËS SË ZOJES NË GJENACANO

Vijim i fq. 6

mori pjesë në Përrurimin e pëlhurës së Zojës së Këshillit të Mirë që, e restauruar pas dëmtimeve të mëdha, në përfundim të diktaturës komuniste që ikona e lirisë së rigjetur të fesë: e pranishme në të gjitha manifestimet e para fetare të viteve '90, u ruajtur pastaj në famulli dhe tani u kthye në të gjithë shkëlqimin e vet prej duarve të ditura të restauruesve të Institutit “Palazzo Spinelli” të Firences, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe e financuar prej kësaj të fundit.

Dreka e thjeshtë pranë Kuries dhe një pushim i merituar u bënë të nevojshëm para se të niste Procesioni me figurën e “Zojës së Shkodrës”, me një pjesëmarrje të madhe të popullit, nga Katedralja deri te Shenjtërorja e cila gjendet në hyrje të qytetit, poshtë kalasë, në malin e vogël në kryqëzim të lumenjve Buna e Drin. Kjo ngjarje nuk kaloi pa rënë në sy dhe kjo kuptohet edhe nga fakti se Mediat i dhanë jehonë të madhe dhe se, me kalimin e procesionit fetar, që e mundur të vëreheshin shenja respekti edhe nga ana e disa myslimanëve, në pjesën e rrugës që kalon nga dy xhami. Pastaj mbrëmja u mbyll me një darkë vëllazërore pranë Shtëpisë së Motrave Vinçenciane të Shkodrës dhe me thjeshtësinë e bashkëndarjes pranë studios së Arqipeshkvit.

Më 26 prill, dita filloi me kremtimin e Lavdeve të Mëngjesit pranë kapelës së Kuries dhe, pas një mëngjesi të thjeshtë, u nisëm drejt Shenjtërores së Zojës së Këshillit të Mirë për Kremtimin Solemn Eukaristik, të transmetuar drejtpërdrejt prej televizioneve lokale dhe prej Radio Marisë Shqiptare. Leximi i Dekretit papnor dhe bekimi apostolik bënë përmbylljen e Ritit gjatë të cilit, në homelinë e tij, Kardinali kujtoi rëndësinë e devocionit ndaj Zojës së Këshillit të Mirë për popullin shqiptar gjatë vuajtjes së gjatë të shkaktuar prej pushtimit otoman fillimisht dhe pastaj prej përndjekjes komuniste; dhe se si ky devocion ka qenë mbështetja e popullit gjatë gjithë historisë së tij të vështirë.

Me mësimin e saj që paraqet Krishtin si Shpëtimtar të botës të cilin duhet ta dëgjojmë dhe duke u dëftuar si zbulim i mëshirës së Hyjit, Maria është Nëna që e shoqëron dhe e udhëheq popullin e krishterë në “rezistencën” e vet të fesë, duke e nxitur të qëndrojë në fe siç kanë bërë Martirët e lumnuar më 5 nëntor 2016.

Kardinali, pastaj, para se t'ia besonte ndërmjetësisë së Virgjërës Mari nevojat e popullit të Hyjit që është në Shqipëri, gëzimet e tij, dhimbjet e tij, pritshmëritë e tij, zhgënjimet, shpresat, familjet, meshtarët, të kushtuarit e të kushtuarat, krejt kombin shqiptar dhe gjithë Kishën, kujtoi si vizitën e Atit të Shenjtë Françeskut më 21 shtator 2014, si ngjarjen e lumnimit të Martirëve, duke theksuar në mënyrë të veçantë figurën e dom Mikel Beltojës.

Nga ana e vet, Arqipeshkvi Massafra, në përfundim të Meshës, i prekur, dëshiroi të falënderonte Atin e Shenjtë në personin e Kardinalit Rodé, duke e lutur t'i çojë Papës këto falënderime dhe dëshminë e fesë së këtij populli.

Falënderoi pastaj Ipeshkvijtë George Frendo të Tiranës, Ottavio Vitale të Lezhës, Rrok Gjonlleshaj të Tivarit dhe ipeshkvin e nderit të të njëjtës Dioqezë, Zef Gashi, të pranishëm në kremtim, së bashku me të

Ngarkuarin për Punët e Nunciaturës apostolike në Tiranë, Imzot Romanus Mbena dhe meshtarët e ardhur edhe nga Kosova, nga Mali i Zi dhe nga Dioqezat e Shqipërisë.

Gjithashtu, dëshiroi të kujtonte rëndësinë e madhe simbolike të këtij kremtimi në të cilin edhe një herë u shfaq vullneti i këtij populli të

krishterë për të rilindur, popull që, i fortë në vetëdijen e pranishme të Hyjit në mesin e vet, vazhdon të ecë në kohë dhe të dëshmojë ringjalljen e Zotit nëpërmjet një jete tërësisht të përqendruar në të mirën.

Kardinali Rodé përfundoi duke pohuar se ka konstatuar fenë e këtij populli dhe ndjenjën e madhe të përkatësisë në Kishë, duke i nxitur të gjithë që të mbeten të patundur në fe.

Mes drekës, të ngrënë pranë Seminarit Ndërdioqezan, dhe darkës vëllazërore pranë bashkësisë së Fretërve Minorë të Kuvendit “Shën Françesku” të Shkodrës, Kardinali dëshiroi të

vizitonte Kuvendin e Klariseve pranë ish kuvendit të Fretërve Minorë të shndërruar në burg dhe vend torturash prej komunistëve e pastaj mori pjesë në Rruzaren tradicionale, në formën e saj të kënduar, gjithnjë pranë Shenjtërores së Zojës së Këshillit të Mirë, përsëri e mbushur plot me besimtarë. Në përfundim të Rruzares i nxitu të pranishmit të vazhdonin këtë traditë që përgjatë shekujve ka garantuar ruajtjen e fesë në Shqipëri.

Ajo e 26 prillit që një ditë historike në të cilën Hirësia e Tij që gjithnjë i pranishëm, pavarësisht prej intensitetit të momenteve kremtuese, duke marrë pjesë me ndjenjë të admirueshme pranë aktive, si atë i mirë që bashkëndan ndjenjat dhe jetën e bijve të vet.

Më 27 prill, pasi përfunduan mundimet apostolike, i shoqëruar prej Delegacionit zyrtar, Kardinali shkoi në Dioqezën e afërt të Sapës ku, me udhëheqjen e Dom Simon Kullit, vizitoi fillimisht Katedralen e

Laçit të Vaut të Dejës dhe Qendrën e Caritas-it Dioqezan; pastaj Karmelin e Nënshatit, ku edhe kremtoi Eukaristinë dhe bashkëndau drekën me bashkësinë monastike dhe Fretërit Karmelitanë. Pastaj, pasdite, shkoi në Dioqezën e Lezhës për vizitën në Seminarin e Ecjes Neokatekumenale, para se të kthehej në Shkodër, ku dita përfundoi me darkën vëllazërore pranë Shtëpisë së Salezianëve.

Me kthimin në Romë, më 28 prill, përfundoi vizita e Hirësisë së Tij në Shqipëri,

tokë ku shpresa preket me dorë, tokë me një mijë kundërshti, tokë që jeton adoleshencën e vet në zbulim të vetvetes dhe të identitetit të vet, tokë që ka nevojë të shoqërohet e të mbështetet në rrugëtimin e vet drejt moshës së pjekur, asaj të vetëdijes së plotë dhe përgjegjësisë së plotë për të ardhmen e vet, pa shmangie apo shkurtore që, sot, duket se janë rruga më e thjeshtë për t'u bërë ballë vështirësive që nuk mungojnë.

Kisha në Shqipëri e ndien fort këtë detyrë të shoqërimit dhe të drejtimit; prandaj synon formimin e barinjve të vet dhe të besimtarëve të vet, punon në shprehjet shumëformëshe të bamirësisë për të shfaqur gëzimin e përkatësisë në Krishtin dhe, megjithëse e varfër në mjetet e jetesës, gëzon kujdesin dhe dashamirësinë atërore të Kishës së Romës ndaj së cilës vazhdon të dëftojë besnikëri, në vazhden e Martirëve të vet, kampionë të lidhjes bijësore me katedrën e Pjetrit.

Në lavd të Krishtit. Amen.

Atë Luigi Aluisi OFM



SIMPOZIUM NDËRFETAR NË SHKODËR

“Gruaja në komunitetet fetare dhe në shoqërinë Shqiptare sot”.



Ditën e enjte me datën 11 majë 2017 është mbajtur takimi në ambientet e Seminarit Ndërdioqezan Shkodër në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Islame "Kolegjin Universitar Beder" dhe me "Akademinë Teologjike Ortodokse" të Durrësit. Takim i organizuar në nivel Akademik mes tre shkollave Teologjike kishte si temë "Gruaja në komunitetet fetare dhe në shoqërinë Shqiptare sot". Edhe një herë në këtë takim është vënë në dukje harmonia që qëndron mes komuniteteve Fetare në Shqipëri. Tolerancë e karakterizuar prej dialogut dhe dëshirës për të arritur të mirën e shoqërisë Shqiptare.

Ky simpozium u organizua në vazhdimësi të tre takimeve që ishin realizuar më parë mes tre Akademive dhe në këto takime dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në mbajtjen e disa temave mjaftë aktuale për shoqërinë tonë Shqiptare. Që në hyrje të takimit të fundit, Drejtori i Studimeve në Institutin Filozofik dhe Teologjik – Shkodër, Atë Mario, e vuri theksin mbi rëndësinë e këtyre takimeve, duke na kujtuar fjalët e Atit të Shenjtë Papa Françesko, "përtej motiveve që mund të kërkojmë për t'u takuar, e rëndësishme është të qëndruarit së bashku, ajo ka vlerë në vetvete".

Në paraqitjen e temës ishin të ftuara tre zonja, ku secila bëri një reflektim duke u nisur nga pikëpamja e vet fetare mbi rolin dhe kontributin e gruas sot në shoqërinë tonë. Menjëherë pas fjalës së Atë Marios fjalën e mori zonja Violeta, përfaqësuese e palës Ortodokse, e cila bëri një paraqitje mjaftë interesant, ku theksoi që gruaja ortodokse, pas rënies së komunizmit, filloi të jepte kontributin e saj në Kishën Ortodokse duke filluar nga viti 1992, në mënyrë të veçantë me krijimin e "lidhjes së grave".

Një moment tjetër shumë i rëndësishëm dhe historik për gruan Ortodokse është edhe fillimi i studimeve teologjike, gjë e cila ishte krejt e re për Shqipërinë, sepse sikurse e dimë këto studime ofroheshin vetëm për ata që dëshironin të bëheshin klerikë. Këto gra pas studimeve filluan të japin një kontribut shumë të vlefshëm për Kishën në fushën e edukimit, në kopshte dhe shkolla, duke kultivuar kështu dashurinë për Krishtin. Mjaftë e rëndësishme është ndihma e grave ndaj të sëmurëve, ku ato kontribuojnë me blerjen e ilaçeve dhe me përkujdesjen ndaj tyre. Një kontribut tjetër që ato japin janë edhe vizitat nëpër burgje, duke i nxitur të burgosurit për një jetë më me shpresë dhe bekime prej Hyjit. Pra gruaja jep një kontribut në çdo sferë të shoqërisë, por mbi të gjitha në formimin e një familjeje të krishterë. Në kumtesën e mbajtur nga motër Moza "Gruaja sipas mësimit të Kishës katolike" ajo filloi duke marrë si të mirëqenë se gruaja nuk është subjekt për t'u diskutuar se cili është roli i sajë në shoqëri apo roli i sajë në një institucion, kjo për faktin se gruaja është qenie njerëzore e krijuar nga Hyji dhe si e tillë duhet konsideruar. Duke u nisur nga (Zan 1,27). "*Hyji krijoi njeriun në përngjasimin e vet, e krijoi në përngjasimin e Hyjit; i krijoi mashkull e femër*" del se te dy, burri dhe gruaja, janë qenie njerëzore në shkallë të barabartë, të krijuar në përngjasimin e Hyjit e, asnjëri nuk është superior apo inferior ndaj tjetrit. Gjatë kumtesës së saj motër Moza vuri theksin edhe mbi personin e Marisë; grua për ekselencë që Kisha katolike e mban superiore dhe si e tillë është për të gjithë besimet. Maria, është pikërisht ajo shenjë profetike e një roli perfekt të

gruas, si shprehje e pranisë së Shpirtit të Zotit në jetën e njeriut. Risia e Koncilit të Vatikani II, ka njohur më së miri rolin e gruas në Kishë dhe vë në pah bukurin e thirrjes së gruas e cila po zhvillohet në plotësi.

Në ditët tona gruaja po fiton në shoqëri një ndikim, një rrezatim, një fuqi të paarritur më parë. Ardhja e misionarëve/misionareve ka ndihmuar në shumë nivele dhe shumë e vyeshme ka qenë ndihmesa dhënë gruas, duke ia rikthyer asaj dinjitetin e humbur për shkak të shtypjes. Kjo ndihmesë i është dhënë nëpërmjet shkollimit; faktor të gjallë të këtij realiteti kemi të gjitha shkollat katolike, ku institutet femërore drejtojnë, bashkëpunojnë ose marrin pjesë në shkolla; një shembull konkret është edhe Instituti ynë i filozofisë / teologjisë këtu në Shkodër, ku motra të

Instituteve të ndryshme rregulltare e frekuentojnë e jo vetëm si studente, por që prej pothuaj 10 viteve, motrat japin edhe mësim, gjë kjo që ishte e pamundur më parë.

Pas fjalës së Motër Mimosës fjalën e mori zonja Fatma, përfaqësuese e Komunitetit Mysliman e cila na bëri një paraqitje të temës "gruaja në Islam dhe kontributi i saj në shoqërinë Shqiptare". Ajo bëri edhe një paraqitje të të drejtave të grave në Islam, duke na cituar një verset nga Kurani, "Njerëz ju këshilloj të merrni parasysh të drejtat e grave, ju i morët gratë si dhuratë nga Allahu, ju keni të drejta mbi gratë gjithashtu ato kanë të drejta mbi ju". Zonja Fatma na paraqiti edhe një panoramë historike, duke na kujtuar se gratë para arritjes së Islamit, në Arabi, nuk kishin asnjë lloj të drejte, shpesh ato shiheshin si barrë dhe si turp për një baba, shpesh herë ato dënoheshin duke i mbuluar nën dhë edhe të gjalla. Kjo histori zgjati deri me ardhjen e Profetit, i cili e çliroi gruan nga shtypja dhe poshtërimi. Islami bëri që të ndreqej mentaliteti i gabuar, dhe i sjelli gruas dinjitetin e duhur, duke u kthyer pozicionin e tyre si qenie njerëzore. Islami shpalli se gratë janë një faktor kyç për zhvillimin e vendit. Profeti Muhamed me mësimet e tij nisi të ndërgjegjësojë burrat dhe të ngre pozitën e gruas në çdo fushë të jetës, theksoi zonja Fatma. Ai shpalli barazinë ndërmjet burrave dhe grave, duke i marrë parasysh natyrat dhe tendencat e të dy gjinive. Sipas Islamit



nuk ka asnjë dallim ndërmjet burrit dhe gruas në besimin ndaj Zotit dhe bazave të fesë, në njohjen ndaj urdhrave dhe këshillave të Krijuesit në lidhje me këtë botë dhe përjetësinë. Pra Islami i ka dhënë gruas lirinë, dinjitetin dhe të drejtat që nuk njiheshin përpara. Pas kumtesave, jemi bashkuar të gjithë në një drekë vëllazërore, ku kemi mundur të kemi një bashkëndarje mbi temën të cilën kishim dëgjuar. Pas drekë kishim takime diskutimi në grupe. Dhe këtë ditë të mrekullueshme e kemi mbyllur me një ndeshje futbollit për meshkujt dhe një ndeshje volejbollit për femrat. Dhe së fundmi kam dëshirë që të falënderoj Hyjin për këtë mundësi që na ka dhuruar, për t'u takuar së bashku, dhe për të dialoguar mes nesh. Dhe një falënderim i përzemërt në emër të Atë Marios, Drejtor i Institutit Filozofik- Teologjik Shkodër, i shkon Seminarit Ndërdioqezan të cilët kanë qenë mikpritësit. Zoti bëftë që kjo vëllazëri dhe ky bashkëpunim të rritet më shumë.

Kristjan Marku

DITA RINORE DIOQEZANE ME 8 PRILL 2017



Me 8 prill 2017 u kremtua Dita Dioqezane e Rinisë në nivel dioqezane. Takimet u bënë në Cdo Zonë baritore, d.m.th. në katër zonat baritore. Imzot angelo Massafra, arqipeshkvi ynë shkoi në cdo vend ku ishin mbledhur ti rinje mbajti të gjithëj njeti n fjalën, si vijon:

“Fort të dashur të rinj,
vij e ju takoj në vendet e Dioqezës ku jeni mbledhur për të kremtuar Ditën që Kisha jua ka kushtuar juve. Ajo ju ndien si bij të saj, ashtu si edhe në fakt jeni.

Dita që po jetojmë, e Diela e Larit, është një simbol shumë i fortë i jetës sonë, pasi në këtë ditë kujtojmë momentin e lavdisë së Jezusit, që



hyn në Jerusalemin, në kulm të rinisë dhe të misionit të vet. Por ky moment lavdi nuk është i shkëputur prej Mundimeve që Ai do të përjetojë pak më vonë dhe që do ta çojnë në fillim në kryq dhe më pas në ngjallje.

Edhe një herë Jezusi, Mësuesi dhe Zoti ynë, me përvojën e Vet na mëson se jeta përballohet me guxim, duke e ditur se ajo sjell edhe momente të dhimbshme, por që tejkalohen me qetësinë e brendshme të atij që është duke jetuar plotësisht, pa u fshehur apo pa i anashkalluar ato. Ky është çelësi i suksesit, edhe nga një pikëpamje vetëm njerëzore.

Por për ne që jemi nxënës të Jezusit ekziston një vlerë shtesë: vetëdija se nuk jemi vetëm në përballimin e jetës. Kemi pranë nesh praninë e gjallë dhe të vërtetë të Jezusit, që na ka thënë: “Dhe, ja, unë jam me ju gjithmonë - deri në të sosur të botës!” (Mt 28,20b). Jemi pjesë e një bashkësie personash besimtarë si ne dhe që, ashtu si ne, janë në ecje, domethënë Kisha: duke ndihmuar njëri-tjetrin mund të shkojmë larg.

Papa Françesku, në mesazhin që ju ka dërguar për këtë ditë dhe që ju ftoj ta lexoni drejtpërdrejt në sitin e Vatikanit, flet për Kishën duke thënë: “Përvoja e vërtetë si Kishë nuk është si një flashmob, ku mund të takohesh, ku bën një paraqitje dhe pastaj secili shkon në punë të vet. Kisha sjell me vete një traditë të gjatë, që përçohet prej brezit në brez, duke u pasuruar në të njëjtën kohë me përvojën e çdo individi. Edhe historia jonë e gjen vendin e vet brenda historisë së Kishës”. Dhe vazhdon duke ju propozuar si model Marinë e Nazaretit, që, në takim me traditën, të përfaqësuar prej Elizabetës, di të ruajë në zemër dhe t'i meditojë veprat e mrekullueshme që Hyji ka bërë në histori.

Fort të dashur të rinj, ju jeni vazhdimi i kësaj historie të Kishës dhe me jetën tuaj jeni duke ndërtuar historinë e Kishës së sotme. Për këtë arsye ju ftoj që të jeni të lidhur fort me Jezusin, me qëllim që me praninë



e tij në jetën tuaj të dalloheni prej të tjerëve. Etërit e Kishës, kur flisinin për të krishterët e parë, i përshkruanin si persona shumë normalë, njëllonj si të gjithë, por të aftë që të dalloheshin në mjedisin ku jetonin. Kështu ju sot: dallohuni prej të tjerëve! Jetoni së bashku me të tjerët, por dallohuni prej tyre nga mënyra se si e konceptoni jetën, se si mendoni, se si silleni, se si i përmbushni detyrat tuaja të përditshme të studimit apo të punës pa bërë kompromise me të keqen.

Jini prani e gjallë e Krishtit, “era e mirë e Krishtit” siç thoshte Shën Pali. Por sidomos, uroj që të dini të dalloheni prej të tjerëve me praktikimin e dashurisë së krishterë. Duajini të gjithë, duani gjithmonë, duani dhe falini fyerjet, sepse Jezusi ka thënë: “Nëse e doni njëri-tjetrin, të gjithë do t’ju njohin se jeni nxënës të mi” (Gjn 13,35).

Atëherë vazhdoni të gëzoni dhe të festoni. Ditët e pendesës dhe të agjërit kreshmor **ia lëfshin vendin** gëzimit të Pashkës, sepse Krishti vdes dhe ngjallet për të na dhënë një jetë të re dhe uroj që edhe ju të doni ta pranoni dhe t’ia përçoni botës mbarë me zellin dhe bujarinë me të cilën jeni të aftë, me freskinë e moshës suaj të re. Duke kënduar dhe vallëzuar, thuajuni të gjithëve që Krishti është Ngjallur dhe që të gjithë mund të ngjallemi me Të dhe të rimarrim ecjen me shpresë.

Urime me gjithë zemër të gjithëve ju, familjeve tuaja, miqve tuaj, të gjithë personave tuaj të dashur: thuajuni të gjithëve që ipeshkvi i përshëndet dhe i fton ta jetojnë Pashkën plotësisht të pajtuar me Hyjin dhe me të afërmin. Urime sërish”.

Në Zonën nr. 2 në Barbullush

Më 8 prill kemi kremtuar ditën botërore të rinisë, këtë vit në rang dioqezash. Në dioqezën tonë janë vënë në lëvizje zonat baritore dhe secili grup ka zgjedhur vendin dhe kohën për këtë iniciativë që e ka kaq shumë për zemër Papa, që t’i bëjë të rinjtë protagonistë të jetës së Kishës. Zona nr. 2 (Berdica, Trushi, Dajçi i Bregut të Bunës, Velipoja, Ana e Malit, Beltoja, Rranza Bushat e Barbullushi) ka zgjedhur kishën dhe famullinë e Barbullushit.

Më shumë se 350 të rinj të ardhur nga fshatra të ndryshme, të udhëhequr nga motrat dhe meshtarët e tyre, kanë mbërritur në
Vijon në fq. 10



DITA RINORE DIOQEZANE ME 8 PRILL 2017

Vijim i fq. 9



Barbullush plot me zell për të marrë pjesë në këtë takim. Tema e zhvilluar është marrë nga mesazhi i Papa Françeskos për këtë rast “Gjëra të mëdha ka bërë për mua i Gjithpushtetshmi”. Don Marjan Gega u ka



prezantuar të rinjve temat kryesore të zhvilluara nga Papa, në të cilat e paraqet Marinë si një e re plot jetë, plot zell që vihet në lëvizje për të ndihmuar atë që ka nevojë dhe zbulon dashurinë vepruese të Hyjit në jetën e saj. Modele të tjera të prezantuara kanë qenë ato të martirëve tanë dhe grupi rinor i Rranza Bushatit, i udhëhequr nga don Dritan Ndoci, ka prezantuar dramën e jetës së seminaristit të ri, Mark Çuni, i



dënuar për vdekje padrejtësisht gjatë komunizmit. Drama u prezantua aq bukur sa nuk kaloi pa lënë gjurmë dhe pa mallëngjyer të pranishmit.

Arqipeshkvi mons. Angelo Massafra, pas prezantimit të dramës, ka përshëndetur dhe inkurajuar për të qenë të rinj të guximshëm, dëshmitarë të gëzueshëm të fesë që kemi marrë si dhuratë.

Paraditja është mbyllur me një orë adhurim e udhëhequr nga diakoni don Gasper, dhe mundësia e të rinjve për t'u rrëfyer në prag të Pashkëve. Agapeja vëllazërore e ka mbyllur këtë ditë të bukur plot me mesazhe pozitive për të gjithë pjesëmarrësit.

Don Rolando Reda

Në Zonën nr. 3 në Bardhaj

Nisi ma së mirit me të parët të rinjte nga Prekali (Dukagjini) të cilët ishin mjaft entuziast dhe plot energji dhe dëshirë për të takuar të rinjtë të tjerë të famullive të ndryshme! Vazhdon me mbërritjen e të rinjve nga Kelmendi, Shkreli, Kopliku, Bajza, Vranka, Hoti Ri, Gruda! Filluam ditën me mikpritjen (banse, muzike) dhe prezantimin e grupeve, pastaj u zhvendosem tek salla 'Don Orione' ku padër Aleksandri mbajti një kumtesë me një mesazh të fortë se si të rinjtë duhet të jenë plot fe, shpresë e dashni! Si duhet të dimë ti përgjigjemi Po Zotit dhe veprës së tij! E si të rinj të rritun në fe bashkë celebruam meshën e shenjtë! Momenti tjetër ishte dreka dhe mbas drekës lojta të ndryshme të organizume, muzikë me deejai profesional, ku shiheshin të rinj plot shpresë, plot energji pozitive që rrezatonte në fytyrën e gjithsecilit!

Ajo që duhet theksuar ishte se dita mbaroi aq shpejt sa hap e mbyll sytë, gjithashtu shumë të rinj u prezantuan e u takuan, shndërruan mendime dhe eksperiencat të ndryshme në shërbim të të ardhmes, luajtën dhe u argetuan duke dhënë shembullin se si në Kishë ne rritena si besimtar, jetojmë si vëllezër dhe shërbejmë si shërbëtor të Krishtit!"

Donald Vulaj

Në Zonën nr. 4 në Shëldi

Edhe në zonën tonë u mbledhën shumë të rinj për të festuar ditën e rinisë.



Famullia e Ragmit dhe Shëldisë e kishin përgaditur programin e kësaj dite. Pasi u mbledhën të rinjtë e zonës programi filloi me një dramë që titullohej "Gjaku i martirëve fara e të krishtereve" dhe më pas u vijua me një këngë kushtuar pikërisht tre famullitarëve të cilët kanë shërbyer në këtë famulli.

Më pas programi vazhdoi me procesionin dhe lutjen e Rruzares nga qela drejt Kishës, ku të rinjtë mbanin kuadrin e Martirëve.

Te Kisha u kremtua Mesha e Shenjtë e udhëhequr nga Don Rafaeli vikar i zonës së bashku me famullitarin Dom Charebeli. Nuk mungoi as pershendetja e Bariut të dioqezës sonë Monsinjon Angelos, i cili përshëndeti të rinjtë, duke folur edhe mbi mesazhin e papës Francesk për ditën botërore të rinisë.

E falenderojmë Zotin për cdo gje që ka dhuruar gjatë kësaj dite në zemrën e të rinjve, dhe i kërkojmë ndërmjetësinë e Martirëve, që ata të jenë model i jetës së tyre.

M. Terezina Jaku sds

LAJME NGA DIOQEZA E SAPËS

DHËNIA E SHËRBESES SË AKOLITATIT
SEMINARISTIT ZEF MARKU

Të dielen e katërt të Kreshmeve, datë 26 mars 2017, gjatë Meshës së Kremtuar në Katedralen Nënë Tereza në Vau - Dejes, seminaristit Zef Marku iu dha shërbesa e Akolitatit, nëpërmjet të cilit iu besua detyra për të ndihmuar meshtarët dhe diakonët në kryerjen e shërbesave të tyre, dhe si ministër i jashtëzakonshëm mund t'u shpërndajë Eukaristinë të gjithë besimtarëve dhe të sëmurëve.

Mesha u udhëhoq nga Administratori dioqezan i Sapës në bashkëkremtim me Rektorin e Seminarit Ndërdioqezan “Zoja e Këshillit të Mirë” – Shkodër, dom Leonardo Falco dhe meshtarë të tjerë. Me falenderimin ndaj Zotit për dhuratën e thirrjes së Zefit, dom Simoni shprehi gëzimin e tij për përparimin e tij shpirtëror dhe intelektual, ku sipas gjykimit të eprorëve kompetent që kujdesen për të, po i jepet edhe shërbesa e akolitatit, një hap më shumë që e ofron drejt meshtarisë. Në vazhdim të homelisë së tij, dom Simoni kujtoi se thirrja lind prej takimit të



dy lirive, asaj hyjnore dhe njerëzore, dhe është një ngjarje personale por edhe e bashkësisë edhe kishtarë, sepse çdo thirrje nxitet prej Zotit si një dhuratë për bashkësinë e krishterë. Duke përfunduar dom Simoni ftoi të gjithë bashkësinë famullitare dhe dioqezane për t'u lutur për thirrje të reja, për të shpallur Ungjillin e Krishtit.

Më pas riti i dhënies së Akolitatit vazhdoi me lutjen e bekimit, dorëzimin e bukës dhe të verës, si dhe me ritet e tjera vazhduese.

Shërbesa e akolitatit e angazhon edhe më shumë të zgjedhurin për të jetuar në mënyrë gjithnjë e më intensive flinë e Zotit duke ia përshtatur gjithnjë e më shumë qënien e tij dhe të vepruarit e tij. Falenderojmë Zotin për dhuratën e thirrjes bërë në personin e Zefit, në të cilin thirrja po rritet e piqet çdo ditë hap pas hapi, e do të kurorëzohet me Shugurimin Diakonal e Meshtarak.

MOTËR MARIA KALETA NDEROHET ME TITULLIN
“KRYQI I LARTË PËR KISHËN DHE PAPËN”

Me kërkesën e Kuries Dioqezane të Sapës, Ati i Shenjtë Francesku është i denjuar t'i dhurojë Motër Maria Kaletes, stigmatine, Dekoraten e Kryqit të Lartë për Kishën e Papën (Pro Ecclesia et Pontifice) të themeluar kryesisht për ata që janë dalluar për (Përkushtimin, Zellin, Shërbimin) dhe angazhimin e tyre, duke i dhënë njëkohësisht mundësinë, (të drejtën) për ta treguar këtë Dekoratë.

Në festën e Lajmërimit të Zotit që ndryshe njihet si festa e Zojës Nunciatë, datë 25 mars 2017, nën organizimin e famullitarit Dom Vincenc Pali, bashkësia katolike e famullisë Shën Nikolli Pistull, u mbledh në kremtimin e ceremonisë së rastit.

Nderuan me praninë e tyre përfaqëuesi i Selisë së Shenjtë në vendin tonë, i ngarkuari me punë në Nunciaturën Apostolike, Mons. Romanus Mbeni, meshtarë, rregulltarë e rregulltare, Nëna Gjenerale e motrave Stigmatine e ardhur enkas për këtë rast nga Italia, përfaqësues të pushtetit lokal si dhe besimtarë të shumtë.

Që në fillim të kremtimit të udhëhequr nga Administratori Dioqezan i Sapës, dom Simon Kulli, ai u shprehu mirëseardhjen të gjithëve dhe mirënjohjen ndaj Zotit duke e falenderuar për dhuratën e jetës dhe shëndetin e plotë të Motër Maria Kaletës; për shërbimin e saj për shumë e shumë vite, e mbi të gjitha gjatë regjimit komunist; t'i japim lavdi Zotit për punën dhe përkushtimin e ringjalljes së fesë në zemrat e besimtarëve në shumë fshatra të Zadrimes, punë të cilën besoj se të gjithë ju e njihni dhe e dini shumë mirë se, ajo me thjeshtësinë e saj e realizonte shpalljen e Ungjillit me shumë dashuri dhe përvujtëri. Ndërsa gjatë homelisë së rastit, dom Simoni iu drejtua Motër Maries duke i thënë se, veprimtarinë tënde të 45 viteve të tua në noviciat, e flet më së miri fytyra e jote e vuajtur me rrudhat e saj, sepse je munduar gjithmonë t'i qëndrosh afër xhaxhait tënd, Martirit dom Ndoc Suma në vitet e vuajtjeve të tij nëpër

burgje, dhe bashkëmotrës tënde martire, Marije Tuci. Ti, halla Marije siç edhe të thërrasin e gjithë bashkësia, je kushtuar vullnetarisht për t'iu shërbyer të gjithëve në kishë në shërbim për më të vegjlit, të sëmurët, të vuajturit, të varfërit, në çdo aspekt, social - kulturor, në të gjitha rrethanat. Halla Marije, si Administrator i kësaj Dioqeze e falenderoj

Zotin për jetën tënden rregulltare, dhe të falenderoj Ty, për dashurinë e shprehur në vepër, për këtë vend dhe popull, kaq të vuajtur dhe uritur për Zotin. Gjatë këtyre viteve të shërbimit tënd je angazhuar që ta shuash këtë uri me Fjalën e Zotit dhe me sakramentet e shenjta.

Gjithashtu, Dom Simoni kujtoi dhe nuk mund të mos e përmendte edhe përkushtimin e saj ndaj tij dhe dom Marjan Lumçit; ndikimin që ajo pati në zbulimin e thirrjes së tyre meshtarake, dhe me përlësi iu drejtua me fjalët: Të falem Halla Mari, që me ndihmën e Zotit dhe me lutjet tuaja që na kanë shoqëruar pa nda, ia arritëm dëshirës për të qenë një nga shërbëtorët e Zotit.

Më pas, Mons. Romanus lexoi dekretin e dërguar nga Vatikani në të cilin shkruhej titulli zyrtar dedikuar Motër Maria Kaletës. Vetë motër Maria mes

emocioneve të shumta shprehu falenderimet e saj për këtë nder dhe mirënjohje që po i bëhej, dhe me modestinë më të madhe thoshte se “nuk i meritoj këto”.

Motër Maria Kaleta është motra stigmatine që gjatë gjithë regjimit, edhe pse në fshehtësi, iu përkushtua jetës së murgeshës ku pavarësisht se ka jetuar mes sakrificave, vuajtjeve e përndjekjeve, së bashku me të ka jetuar edhe “feja” pa u lëkundur asnjëherë. Ajo është një martire e gjallë e ditëve tona, që me dëshminë e saj së bashku me Kardinalin Dom Ernest Troshanin, me 24 shtator 2014 përlotën Papa Franceskun në Katedralen e Tiranës.

Sot Motër Marija gëzon plot 88 vjet. Jeta e saj është një dëshmi me plot sakrificë, dhe herë herë me sfida që ia kanë lodhur shpirtin, por nuk u dorëzua kurrë, duke u mbështetur vetëm në Jezu Krishtin.

Violeta Marashi





në Lateran



Brcelonë
Sagrada Familia



Genazano



Genazano



Kardinal Rode

Lezhë, 17 Janar 2017

HAPËSIRË MEDIATIKE

Regjistrohu në kanalin tone!

Ngjarjet Kisha Katolike Shkoder Pult

Do të gjesh video të ngjarjeve
më të rëndësishme të dioqezës



facebook



Drejtues
Imzot Angelo Massafra

Redaksia
Arqipeshkvia

Lektore
Emanuela Marku Matija

Faqesia
Luigj Mila

Shtypshkronja
"Gjergj Fishta"
Lezhë